

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e –II–
KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR

Procesverbal Nr. 85
nga mbledhja publike e mbajtur më **16.10.2007**
kryesuar nga **Rifat Krasniç**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

- | | | |
|-------------|--------------------|--------------|
| 1. Rifat | KRASNIÇ | kryetar |
| 2. Lulzim | ZENELI | nënkryetar-I |
| 3. Jusuf | SUTAJ | |
| 4. Shaban | HALIMI | |
| 5. Zyhrrie | MALOKU | |
| 6. Berat | LUZHA | |
| 7. Sadudin | BERISHA | |
| 8. Afrim | ARZUALLXHIU | |
| 9. XHelal | CANZIBA | |
| 10. Fetah | BERISHA | |
| 11. Selvije | HALIMI | |

Munguan :

- | | |
|-------------|-----------------------------------|
| 12. Gazmend | MUHAXHERI |
| 13. Goran | BOGDANOVIĆ -nënkryetar-II- |
| 14. | |

TË FTUARIT : nga MBPZHR

RENDI I DITËS U MIRATUA ME NDRYSHIM :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i çështjeve të rëndësishme për konferencën rajonale dhe sugjerimi i stafit rreth Planit Hapësinor të Kosovës.

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi Rifat Krasniç hapi mbledhjen dhe konstatoi se lidhur me pikën 1 nuk ka vërejtje. Në vazhdim propozoi të ndryshoi rendi ditës për shkak të konferencës rajonale që mbahet këtë javë, por fillimisht sugjerimin e stafit të komisionit rreth planit hapësinor të Kosovës. Komisioni u pajtua.

Shqyrtimi i çështjeve të rëndësishme rreth organizimit të konferencës rajonale dhe sugjerimit të stafit rreth Planit Hapësinor të Kosovës

Kryetari në fillim kërkoi nga stafi të sqaroj procedurën rreth planit hapësinor të Kosovës e cila ka qenë në seancë plenare më 11 janar 2007.

Bajram Badivuku theksoi se ky planë ka hy në procedurën parlamentare sikurse projektligjet në leximin e parë, ndërsa me 11 janar është kërkuar nga deputetët të përmbushen obligimet e Qeverisë sipas nenit 7.2 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor përkatësisht të formohet Këshilli profesional e cila do të jap mendimin në bazë të cilit deputetët do ta votonin këtë plan në leximin e dytë. Seanca plenare ka kërkuar nga komisionet parlamentare të japin mendimet dhe sugjerimet për këtë plan. Pasi ka hy në procedurën parlamentare, ky komision si komision funksional duhet të rekomandoi seancës plenare për procedurën e mëtejme, përfundoi koordinatori i komisionit.

Lulzim Zeneli (kryesuesi ja përcjelli këtë çështje nënkryetarit në procedim) kërkoi nga komisioni që të propozon një sugjerim për këtë plan.

Sadudin Berisha ishte i mendimit që ky plan duhet të mbështetet nga ekipi i ekspertëve sepse ky komision nuk din çka të rekomandoi. Propozoi që kryetari i komisionit të konsultohet me kryetarin e kuvendit, kryesinë e kuvendit dhe MMPH për të arritur tek një qëndrim se si do të procedohet ky plan.

Berat Luzha kishte propozim të ngjashëm dhe propozoi që në fund të jap fjalën ky komision për këtë plan pasi të shkoi kryetari tek kryetari i Kuvendit.

Selvije Halimi rikujtoi komisionin që seanca ka kërkuar mendimin e secilit komision parlamentar dhe formimin e këshillit profesional, gjë e cila nuk është bërë. Mbështeti mendimin profesional lidhur me këtë plan.

Lulzim Zeneli mbështeti propozimin fillestar që të analizohet procedura e mëtejme lidhur me këtë plan në mes të kryesisë dhe Qeverisë, sepse te ky komision nuk ka mbetur procedura sipas rrjedhave të deritashme.

Afrim Arzuallxhiu kërkoi që komisionet parlamentare të përmbushin obligimin me shkrim ashtu si është kërkuar nga seanca plenare.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Kryetari dhe nënkryetari i Komisionit z. Krasniç dhe z. Zeneli të kontaktojnë me kryetarin e Kuvendit rreth angazhimeve të mëtejme lidhur me Planin Hapësinor të Kosovës.

2. Kryesia e Kuvendit duhet të kërkojë nga Ministria e Mjedisit të jap sqarimin rreth mendimit profesional për Planin Hapësinor sipas nenit 7 të Ligjit për Planifikim Hapësinor.

3. Pas plotësimit të kushtit formal sipas nenit të cekur më lart, komisioni mund të vazhdojë me procedimin e mëtejshëm të Planit Hapësinor të Kosovës.

4. Pasi të kontaktoi kryesia e komisionit me kryetarin e Kuvendit, do të hartohet edhe rekomandimi me shkrim nga ky komision, lidhur me Planin Hapësinor të Kosovës.

Në vazhdim komisioni debatoi rreth angazhimeve për konferencën rajonale në hotelin Grand, si vijon :

-Bajram Badivuku (koordinatori i komisionit) gjatë mbajtjes së konferencës rajonale të prezantoi vazhdimisht duke marrë shënime por edhe duke prezantuar në takimet e rëndësishme,

-Të mërkurën në orën 13,30 Shaban Halimi dhe Bajram Badivuku të jenë prezent në Hotelin Grand rreth pritjes së delegacionit nga Shqipëria ,

-Takimi i komisionit me delegacionin nga Shqipëria mbahet në orën 15,00 në sallën N-10 të mërkurën, ndërsa Berat Luzha, Shaban Halimi dhe Fetah Berisha si dhe Bajram Badivuku do të shoqërojnë delegacionin e Shqipërisë në takimin me Kryetarin e Kuvendit dhe ministrin Ardian Gjini në MMPH dhe në darkë,

-Për anëtarët e komisionit : Zyherie Maloku, Fetah Berisha, Jusuf Sutaj, Xhelal Canziba të premtën të sigurohet transporti për në Prishtinë ashtu si kërkojnë këta deputetë (kthim ose ardhje),

-Nga Zeqir Veselaj të kërkojë raportin për konventën e ARHUSIT për deputetin Jusuf Sutaj

-Lulzim Zeneli do të zëvendësojë kryetarin Rifat Krasniç i cili do të mungojë gjatë konferencës rajonale për shkaqe zyrtare, poashtu Gazmend Muhaxherin në fjalimin e cila është e paraparë të shtunën,

-edhe disa detale tjera u debatuan lidhur me konferencën në fjalë, ndërsa mbledhja e radhës u caktua për dt.23.10.2007 me rendin e ditës për projektligjin e OMGJ dhe atë të ushqimit.

Mbledhja përfundoi në orën 12,40

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryetari i Komisionit,
Rifat Krasniç

